VENDIM
Nr.445, datë 16.6.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.437, DATË 8.4.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR ANËTARËSIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË DEKLARATËN "DEKADA E ROMËVE""

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 4 e vendimit nr.437, datë 8.4.2008 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"4. Kontributi fillestar prej 20 000 (njëzet mijë) eurosh, që është vetëm për anëtarësimin në këtë nismë, si edhe shumat e kontributit për secilin vit pasues, që do të vendosen nga Komiteti Drejtues i "Dekadës së përfshirjes së romëve", për vitin 2012 e në vijim, të përballohen nga fondet e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.".

2. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2012.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha